

LIGJ
Nr. 61/2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 13/2015, “PËR POLICINË USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 13/2015, “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 2 fjalët “mbrojtja e pronës” zëvendësohen me fjalët “mbështetja për mbrojtjen e pronës dhe të pasurisë”.

Neni 2

Në nenin 3 pas fjalës “shërbim ” shtohet fjala “stërvitje”.

Neni 3

Në nenin 4 pas fjalës “specializuar” shtohen fjalët “për veprimet policore”.

Neni 4

Në nenin 7 pas fjalëve “me veprimet” shtohen fjalët “ose mosveprimet”.

Neni 5

Në nenin 10 pika 4 shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 11 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Emërtimi i nenit 11 “Seksioni i Policisë Gjyqësore” zëvendësohet me emërtimin “Shërbimi i Policisë Gjyqësore”.

2. Në pikën 1 të nenit 11 fjalia “Seksioni i Policisë Gjyqësore është seksioni përgjegjës, i cili ushtron detyrat e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.” zëvendësohet me fjalinë “Shërbimi i Policisë Gjyqësore në Policinë Ushtarake është struktura përgjegjëse, e cila ushtron detyrat e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore dhe Kodin e Procedurës Penale.”.

Neni 7

Pas nenit 11 shtohet neni 11/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 11/1

Subjektet që ushtrojnë funksionet e Policisë Gjyqësore në Policinë Ushtarake janë:

- a) oficerët e Policisë Gjyqësore në Policinë Ushtarake, drejtuesit dhe inspektorët e strukturave në Policinë Kriminale, në Qarkullimin Rrugor dhe Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin, që përmbushin kriteret sipas ligjit;
- b) agjentët e Policisë Gjyqësore në Policinë Ushtarake, agjentët e strukturave në Policinë Kriminale, specialistët në strukturën e Qarkullimit Rrugor dhe në Inspektoratin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.”.

Neni 8

Pas shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 21 shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) për të dhënë deklarime për rrethanat e ngjarjes sipas parashikimeve në Kodin e Procedurës Penale.”.

Neni 9

Në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 29 pas fjalës “të ndaluar” shtohen fjalët “ si dhe i dërgon në Policinë e Shtetit”.

Neni 10

Në nenin 33 bëhen ndryshimet si më poshtë:

- a) në shkronjën “f” fjalët “mbron pronën shtetërore në administrim dhe përdorim të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë nga veprimtari të kundërligjshme” zëvendësohen me fjalët “mbështet mbrojtjen e pronës dhe të pasurisë shtetërore në administrim e në përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë nga veprimtari të kundërligjshme”;
- b) në shkronjën “k” pas fjalëve “personalitete të larta ushtarake” shtohen fjalët “dhe civile”;
- c) shkronja “n” ndryshohet si më poshtë:
“n) kontrollon masat parandaluese, jep asistencë teknike e ndërhyr për forcimin e masave dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga zjarri”.

Neni 11

Pas pikës 3 të nenit 36 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Oficerët e Policisë Gjyqësore në Policinë Ushtarake dhe persona të tjerë që gëzojnë atributet e OPGJ-së, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi të ngarkuara nga prokurori me hetimin e procedimeve penale, zbatojnë rregullat e legjislacionit në fuqi për ndalimin e publikimit të akteve, që dokumentojnë veprimtarinë procedurale penale dhe çdo informacion tjetër që rrjedh prej tyre.”.

Neni 12

Në fund të pikës 1 të nenit 38 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Trajnimi fillestar i punonjësit të shërbimit në Policinë Ushtarake, që plotëson kriteret ligjore për pranimin në shërbimin e Policisë Gjyqësore, dhe trajnimi vazhdues i tij kryhen në zbatim të ligjit për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.”.

Neni 13

Në nenin 39 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në titullin e nenit, fjala “etika” zëvendësohet me fjalët “rregullorja e brendshme e funksionimit”.

2. Pika 1 e nenit ndryshon si më poshtë:

“1. Gjatë përmbushjes së detyrave të caktuara me ligj, punonjësi i Policisë Ushtarake zbaton rregulloren e brendshme të funksionimit të Policisë Ushtarake, të miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes.”.

Neni 14

Në pikën 3 të nenit 41 fjalët “në masën e gjysmës së pagës mujore” ndryshohen dhe bëhen “në masën e një page mujore”.

Neni 15

Aktet nënligjore

Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për nxjerrjen e aktit nënligjor në zbatim të pikës 2 të nenit 13 të këtij ligji brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më datë 21.7.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13845, datë 5.8.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.